

COVID-19 PËRMBLEDHJE E UDHËZIMEVE #1

Mënyrat e transmetimit dhe periudha e inkubacionit

Transmetimi i COVID-19 ndodh si më poshtë:

1. Më shpesh, COVID-19 përhapet nga një person në tjetrin midis kontakteve fizike.
2. Përhapja nga një person në tjetrin ndodh kryesisht përmes spërklave të frymëmarrjes të prodhuara kur një person i infektuar flet, kollitet ose teshtin.
3. Këto spërkla mund të zbresin në gojë, hundë ose sy të njerëzve që janë afër ose mund të thithen në mushkëri.
4. Kur një person prek një sipërfaqe ose objekt që ka virusin mbi të dhe më pas prek gojën, hundën ose sytë e tij.
5. Transmetimi mund të ndodhë kur pacientët janë simptomatikë, por edhe para shfaqjes së ndonjë simptome, madje edhe nga pacientët asimptomatikë.
6. Pacientët mund të kontaminojnë deri në dy javë pas zhdukjes së simptomave.
7. Në gratë shtatzëna, transmetimi intrauterin ose perinatal nuk është identifikuar.
8. Te gratë që ushqejnë foshnjat me gji, virusi nuk është zbuluar në qumështin e gjirit. Organizata Botërore e Shëndetit aktualisht deklaron se nënat me COVID-19 mund të vazhdojnë ushqyerjen me gji.
9. Lidhur me mundësinë e riinfektimit, përgjigja imune ndaj COVID-19 nuk është kuptuar akoma. Pacientët me infeksion MERS-CoV nuk ka të ngjarë të ri-infektohen menjëherë pasi shërohen, por ende nuk dihet nëse një mbrojtje imune e ngjashme do të vëzhgohet për pacientët me COVID-19.
10. Periudha mesatare e inkubacionit vlerësohet në 5.1 ditë. Kjo sugjeron që periudha e karantinës 14-ditore e rekomanduar nga OBSH është e arsyeshme. 97.5% e njerëzve që shfaqin simptoma do ta bëjnë këtë brenda 11.5 ditëve nga ekspozimi.

Ky dokument është përkthyer nga anglishtja nga Orion JUCJA, Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë. Në rast të ndonjë divergjence midis dy teksteve, dokumenti origjinal i Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike në anglisht prevalon. E drejta e autorit mbetet ajo e Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike.

Për detaje dhe referenca mbështetëse, konsultohuni me dokumentin e plotë udhëzues në www.fip.org/coronavirus

Ky dokument bazohet në provat dhe rekomandimet në dispozicion të organizatave me reputacion në kohën e publikimit. Ai do të përditësohet kur njohuritë e reja bëhen të disponueshme. 26 Mars 2020.

